

VENDIM
Nr. 99, datë 20.3.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS TË SHOQËRISË
“GEN-I TIRANA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 germa “a” të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1038/1 prot., datë 16.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, *“Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 73, seria FK08, të shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 13.9.2018”*,

konstatoi se:

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 73, seria FK08, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 203, datë 13.9.2018, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon më datë 13.9.2023.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1038 prot., datë 9.3.2023 shoqëria, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon: neni 16, germat “a”, “b” dhe “c”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës të shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 14.9.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR

